

Analiza e gjendjes ekonomike të komunitetit serb në Kosovë

Prill
2021



Karakteristikat e shoqërisë së hapur në komunitetin serb të Kosovës

A janë dhe sa të hapura mediat serbe në Kosovë

Organizatat e shoqërisë civile në komunitetin serb të Kosovës – Në mes të perceptimit dhe prezantimit

Partitë politike të serbëve të Kosovës në sistemin politik të Kosovës: Nga pluralizmi deri te monizmi

Qëndrimet e Serbëve të Kosovës mbi institucionet e sigurisë

Qasshmëria e institucioneve për qytetarët në Kosovë

Të drejtat e komuniteteve në Kosovë

Serbët e Kosovës në procesin e dialogut

Analiza e gjendjes ekonomike të komunitetit serb në Kosovë

Titulli i hulumtimit: Analiza e gjendjes ekonomike të komunitetit serb në Kosovë

Botues: KFOS

Për botuesin: Instituti për zhvillim ekonomik territorial (InTER)

Autori: Jovana Jakovleviq, Dragisha Mijaçiq

Gjuha origjinale në të cilën është punuar analiza është gjuha Serbe.

Përkthimi në gjuhën shqipe: Xhenana Azizi

Dizajni: tedel

Shtypshkronja (Tirazhi): tedel (100)

Ky botim u realizua në kuadër të projektit OPEN të implementuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) në bashkëpunim me Institutin për zhvillim ekonomik territorial (InTER). Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e KFOS.

Viti i botimit: 2021

PËRMBAJTJA

01.

HYRJE 6

02.

ANALIZA E GJENDJES 8

Konteksti politik 8

Konteksti socio-ekonomik 9

Qëllimi i hulumtimit 10

Metodologjia dhe modeli i hulumtimit sasior 10

Metodologjia dhe dizajni i kërkimit cilësor 10

03.

REZULTATET E HULUMTIMIT 11

Struktura e ekonomisë së komunitetit serb në Kosovë 11

Punësimi në sektorin privat 15

Sfidat e subjekteve ekonomike të komunitetit serb në Kosovë në të bërit biznes 17

Problemet e përgjithshme të të bërit biznes 17

Problemet e shkaktuara nga futja e taksave prej 100% dhe parimi i reciprocitetit 18

Përdorimi i fondeve të masave për të luftuar pasojat ekonomike të shkaktuara nga 19

Qasja në institucionet financiare për zhvillimin e biznesit 22

Qasja në integrimin ekonomik në Kosovë 23

1. Tregtia në mjediset tashmë me shumicë shqiptare ose në dyqane në pronësi të shqiptarëve 24

2. Marrëdhëniet ekonomike midis serbëve dhe shqiptarëve 25

3. Pengesat në të bërit biznes midis serbëve dhe shqiptarëve 25

4. Ndikimi i taksave për importet nga Serbia në sjelljen e konsumatorit 27

5. Ndikimi i pandemisë COVID-19 në tregtinë midis serbëve dhe shqiptarëve 28

6. Masat mbështetëse të Qeverisë së Kosovës për qytetarët që u përballen me pandeminë COVID-19 29

04.

PËRMBYLLJA DHE REKOMANDIMET 30

1. Hyrje

Organizata Botërore e Shëndetësisë më 11 mars 2020 shpalli zyrtarisht pandeminë e koronavirusit, të quajtur COVID-19.¹ Shtetet kanë pasur qasje të ndryshme në luftë kundër pandemisë, gjë që ka çuar në rezultate të ndryshme. Kështu, për shembull, qeveritë e disa vendeve i kanë dhënë përparësi parandalimit të përhapjes së virusit duke mbyllur kufijtë e tyre dhe duke kufizuar aktivitetet ekonomike (shumica e vendeve në Evropë dhe Ballkanin Perëndimor). Nga ana tjetër, kishte qasje ku fokusi ishte në ruajtjen e aktiviteve ekonomike (SHBA), por edhe në vendet që u përpoqën të tejkalonin pandeminë duke imponuar imunizimin e popullsisë (Suedi).

Pandemia COVID-19 ka shkaktuar çrregullime të konsiderueshme ekonomike, por edhe ndryshime në funksionimin e vendeve në botë. Ndërmarrjet, institucionet e tjera dhe punonjësit duhej të përshtateshin me realitetin e ri. Pra, me regjistrimin e rasteve të para pozitive me koronavirus në Kosovë, institucionet e Kosovës duke filluar nga 13 marsi kanë futur një numër masash.

Me propozimin e Ministrisë së Financave të Kosovës, Qeveria e Kosovës në fund të marsit 2020 u miratoi **Pakon e ndihmës fiskale emergjente si rrjedhojë e pasojave ekonomike të shkaktuara nga pandemia COVID-19.**²

¹ Organizata Botërore e Shëndetësisë, njoftimi i qashtëm në <http://bit.ly/2M9RYqb>

² Vendimi i Qeverisë së Kosovës Nr. 01/19, i qashtëm në <http://bit.ly/2WK6xCH>

Ndër të tjera, kjo pako e ndihmës fiskale përfshinte edhe mbështetjen financiare për sektorin privat, i cili ishte ndër sektorët e parë të goditur nga rënia e produktivitetit si pasojë e situatës emergjente. Mbështetja u reflektua në mbulimin e kostove mujore të pagave për të punësuarit, subvencionet për qira për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, mbulimin e kostove për kontribute pensionale për paga, subvencione për shoqëritë tregtare që regjistrojnë punëtorët me një kontratë pune së paku një vjeçare dhe sigurimin e likuiditetit financiar për mikro-ndërmarrjet. Për të gjitha masa janë paraparë kritere, vlera dhe afate të caktuara.

Sipas një studimi të realizuar në vitin 2017 nga InTER, në atë periudhë vetëm në komunat në veri të Kosovës u regjistruan 3,180 biznese.³ Meqenëse një numër masash ekonomike të Qeverisë së Kosovës nga Pako Fiskale Emergjente kanë të bëjnë me mbështetjen e sektorit privat, lind pyetja nëse ndërmarrjet serbe të regjistruara në komuna me shumicë serbe në Kosovë ishin të informuara për këtë lloj mbështetjeje dhe në çfarë mase i përmbushnin kriteret e vendosura për pranimin e mjeteve financiare të parapara nga këto masa.

Për më tepër, para shpalljes së pandemisë COVID-19, në fuqi ishte vendimi i Qeverisë së Kosovës për taksën prej 100% për importin e

³ Frikonomia e veriut të Kosovës, InTER 2017, i qashtëm në <https://bit.ly/3aPTQlk>

mallrave nga Serbia (dhe Bosnja dhe Hercegovina). Ky vendim ishte në fuqi nga nëntori 2018 deri më mars 2020, kur filloi heqja graduale e taksës. Me vendimin e datës 31 mars 2020, taksat u shfuqizuan plotësisht, por në të njëjtën kohë ato u zëvendësuan me masa të reja reciproke tregtare që i referohen ekskluzivisht importit të mallrave nga Serbia.⁴ Masat reciproke kryesisht i referohen certifikatave fitosanitare dhe veterinare dhe dokumentacionit përcjellës ku duhet të ceket "Republika e Kosovës" si vend i eksportit, gjë që nuk njihet nga shërbimi doganor serb. Kjo krijon probleme shtesë, kryesisht në realizimin e aktiviteteve tregtare në zonat serbe, të cilat zakonisht varen drejtpërdrejt nga importet nga Serbia dhe furnizimi i qytetarëve me ushqime të nevojshme.

Masat e reja shëndetësore, ekonomike dhe tregtare, paraqesin ndryshime që ndikojnë në biznesin e afaristëve në komunat me shumicë serbe në Kosovë dhe përshtatjen e tyre me rrethanat e reja. Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e mësipërme, ky punim është i ndarë në tre pjesë. Në mënyrë që të sigurohet një pasqyrë më gjithëpërfshirëse e gjendjes, në pjesën e parë është kryer një analizë që përmban numrin e subjekteve ekonomike të regjistruara në komunat me shumicë serbe në Kosovë, numrin e të punësuarve në sektorin privat, aktivitetet dominuese ekonomike dhe sfidat kryesore të biznesit. Pjesa e dytë e punimit i referohet analizës së Pakos

së ndihmës financiare të Qeverisë së Kosovës për sektorin privat gjatë pandemisë COVID-19. Meqenëse kjo analizë është pjesë iniciativës më të gjerë OPEN, pjesa e tretë përfshin një analizë të qëndrimeve të komunitetit serb nga dhjetë komunat me shumicë serbe në Kosovë në lidhje me hapjen e tyre për të integruar afaristët serbë në ekonominë e Kosovës dhe për të përmirësuar bashkëpunimin midis afaristëve serbë dhe shqiptarë.

⁴ Vendimi i Qeverisë së Kosovës Nr. 01/20, i qasshëm në <http://bit.ly/2WK6xCH>

2. Analiza e gjendjes

Konteksti politik

Me miratimin e Rezolutës 1244/99 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, i cili vendosi Kosovën nën protektoratin ndërkombëtar, u krijuan sfida të shumta, qoftë pozitive apo negative, të cilat më vonë ndikuan në demokratizimin, tolerancën ndëretnike, qeverisjen e mirë dhe zhvillimin socio-ekonomik të komunave në Kosovë.

Situata bëhet edhe më tej e pafavorshme për komunitet serbe në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Pastaj, procesi i decentralizimit, i cili është një element kryesor i planit të Ahtisaarit, i përfshirë më vonë në kornizën ligjore të Kosovës, krijoi gjashtë komuna të reja me shumicë serbe. Nga këto, pesë komuna ndodhen në jug të lumit Ibër, si: Novobërda, Graçanica, Ranilugu, Parteshi dhe Kllokoti. Përderisa komunitet me shumicë serbe në veri të Kosovës kanë refuzuar të njohin legjitimitetin e autoriteteve qendrore të Prishtinës, komunitet në jug të Kosovës që nga viti 2009 kanë marrë pjesë në zgjedhjet lokale të Kosovës. Që atëherë, ato janë integruar në sistemin kosovar, dhe në përputhje me rrethanat e tilla, shkalla e përshtatjes dhe integritetit të tyre në sistemin juridik të Kosovës ndryshon nga ato në veri.

Që nga marsi i vitit 2011, dialogu midis Serbisë dhe Kosovës zhvillohet nën kujdesin e Bashkimit Evropian. Ngjarja më domethënëse ndodhi më 19 prill 2013, kur u nënshkrua "Marrëveshja e Parë mbi Parimet që Qeverisin Normalizimin e Marrëdhënieve", e cila njihet ndryshe si "Marrëveshja e Brukselit". Përveç kësaj, mbi njëzet marrëveshje të tjera janë

arritur deri më tani, qoftë në kuadër të negociatave politike ose teknike. Shumica e marrëveshjeve kanë të bëjnë me zgjidhjen e çështjeve teknike të rëndësishme për normalizimin e marrëdhënieve dhe krijimin e kushteve për lëvizjen e qetë të njerëzve dhe mallrave, por një pjesë e konsiderueshme e tyre merret me shpërbërjen e institucioneve të Republikës së Serbisë të pranishme në Kosovë dhe integrimin e tyre në sistemin juridik të Kosovës.

Situata në komunitet me shumicë serbe në veri të Kosovës po ndryshon pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit. Si pjesë e zbatimit të marrëveshjes, Qeveria e Serbisë bie dakord të shpërbëjë qeveritë lokale dhe të fusë masa të përkohshme në qeveritë lokale që funksionojnë në kuadër të ligjeve të Serbisë. Në atë kohë, për herë të parë, në përputhje me ligjet e Kosovës u organizuan zgjedhjet lokale në të gjithë territorin, duke përfshirë komunitet me shumicë serbe në veri të Kosovës (Leposaviq, Mitrovica e Veriut, Zubin Potok dhe Zveçan). Me këtë akt u themeluan katër komuna në veri të Kosovës, e që me gjashtë të tjerat në jug, përbëjnë dhjetë komuna me shumicë serbe në Kosovë.

Sa i përket zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit dhe progresit të dialogut, ky është një proces që nuk shkon gjithmonë drejtë. Në zbatimin e marrëveshjeve të caktuara ose pjesëve të marrëveshjeve dukshëm ka vonesa, kryesisht për shkak të mosmarrëveshjeve politike dhe interpretimeve të ndryshme të dispozitave të rena dakord. Për më tepër, gjatë nëntorit 2018, Qeveria e Kosovës vendosi taksën prej 100% për importin e mallrave nga Serbia (dhe Bosnja dhe

Hercegovina), duke futur fillimisht një taksë prej 10% e më pas prej 100%. Ky vendim i Qeverisë së Kosovës është në kundërshtim me dispozitat e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë CEFTA, si dhe marrëveshjeve të tjera të arritura. Në përgjigje të futjes së këtyre masave, qeveria serbe ka pezulluar pjesëmarrjen e saj në dialogun e Brukselit derisa të tërhiqen vendimet e kontestueshme. Pas më shumë se një viti, në mars 2020, Qeveria e Kosovës miratoi një vendim të ri që shfuqizon taksat e përmendura për importin e mallrave nga Serbia dhe BH. Sidoqoftë, barrierat e reja tregtare janë futur për Serbinë, d.m.th. masat reciproke tregtare që i referohen vetëm importeve nga Serbia.

Konteksti socio-ekonomik

Pas pezullimit të të gjitha aktiviteteve ekonomike globale dhe paparashikueshmërisë së situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, pritet që shumë vende të përballen me një krizë ekonomike, shkalla e së cilës është ende e panjohur. Pas shpërthimit të pandemisë COVID-19 në Kosovë, qeveria kufizoi lëvizjen e njerëzve dhe urdhëroi mbylljen e një pjese të madhe të ekonomisë për më shumë se dy muaj. Masat për të parandaluar përhapjen e pandemisë shkaktuan ngadalësim të prodhimit, i cili çoi në një rënie të bruto produktit vendor (BPV) me 9.28% në tremujorin e dytë të këtij viti.⁵ Sidoqoftë, shkalla e këtij ngadalësimi ekonomik varet nga disa faktorë, të tillë si: aftësia për të kontrolluar përhapjen e virusit, efektiviteti i masave ekonomike të marra nga qeveria për të lehtësuar rimëkëmbjen ekonomike, dhe pritshmëritë e konsumatorëve dhe bizneseve nga sektori privat.

Sektori privat në zonat me shumicë serbe në Kosovë, madje edhe para pandemisë COVID-19, operonte në një mjedis të pafavorshëm afarist të karakterizuar nga sfida të sigurisë, kufizime të tregut, mosnjohje të procedurave administrative dhe probleme në lëvizjen e lirë të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve. Shumica e afaristëve në komunat jugore kanë funksionuar brenda sistemit juridik të Kosovës që nga

viti 2008, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe integritit të komunave në jug të lumit Ibër në sistemin e tyre. Në veri të Kosovës, kjo ndodhi shumë më vonë, më saktësisht vetëm pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit, kur procesi i regjistrimit të subjekteve ekonomike në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë u përmirësua, me çrast numri i bizneseve të regjistruar filloi të rritet. Regjistrimi në sistemin kosovar bizneseve ua mundëson krijimin e rritjes dhe bërjen e biznesit me biznese nga pjesët e tjera të Kosovës, përderisa u sigurohen të drejta dhe detyrime të njëjta që u takojnë nga regjistrimi i biznesit në Kosovë. Ndërmarrjet e regjistruara kanë qasje në tregun e Kosovës pa kufizime të cilat ekzistojnë për ndërmarrjet e paregjistruara ose ndërmarrjet e regjistruara në sisteme të tjera juridike, në këtë rast në atë serb. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për afaristët që merren me tregti. Përkundër faktit se pjesëmarrja e sektorit privat të komunitetit serb në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik të Kosovës është e vogël, në ekonominë lokale, komunat me shumicë serbe kanë pjesëmarrje më të madhe në sektorin e tregtisë dhe shërbimeve, të pasuara nga bujqësia dhe industria e përpunimit.

Megjithëse, mjediset serbe në Kosovë dikur ishin një mjedis i prosperuar afarist, me burime të ndryshme natyrore, industri dhe shkallë të lartë të punësimit në sektorët përkatës, sot kushtet e tilla janë dukshëm më të ndryshme. Në këto mjedise mungojnë investime të konsiderueshme në sektorin privat, ndërsa situata aktuale ekonomike është e pa lakmueshme sepse varet kryesisht nga institucionet serbe dhe shpesh është pasqyrë e paqëndrueshmërisë politike dhe të sigurisë. Njëra nga to ka të bëjë me vendimin e Qeverisë së Kosovës për vendosjen e taksës për produktet e importuara nga Serbia (dhe Bosnja dhe Hercegovina), gjë që ka ndikuar negativisht në sektorin privat në mjediset serbe, duke pasur parasysh faktin se shumica e subjekteve ekonomike janë të orientuara në kryerjen e aktiviteteve tregtare, kryesisht me mallra me origjinë serbe. Kur taksat në fjalë të Qeverisë së Kosovës u shfuqizuan, masa të reja reciproke tregtare u futën për importet nga Serbia, gjë që rëndon më tej kushtet e të bërit biznes dhe zhvillimin e sektorit privat në mjediset serbe.

⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Bruto Produkti Vendor TM2 2020, i qasshëm në <https://bit.ly/38E3yRZ>

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i përgjithshëm i këtij hulumtimi është të kontribuojë në shkallën e hapjes së subjekteve ekonomike të mjedisëve me shumicë serbe ndaj komuniteteve dhe institucioneve tjera. Në një kuptim më të ngushtë, hulumtimi synon të kontribuojë në informimin më të mirë të qytetarëve për gjendjen e ekonomisë dhe qasjen e tyre në mbështetjen financiare për zhvillimin e sektorit privat në komunat me shumicë serbe në Kosovë.

Metodologjia dhe modeli i hulumtimit sasior

Anketimi ballë për ballë në terren u krye në periudhën nga 1 deri më 20 tetor 2020. Gjithsej 582 qytetarë serb u anketuan në të gjithë Kosovën. 50.5% e të anketuarve janë anketuar në jug të lumit Ibër, ndërsa 49.5% e të anketuarve janë anketuar në veri të lumit Ibër. Pyetësi përbëhej nga 65 pyetje dhe përfshinte gjithsej 8 fusha. Mostra ishte e qëllimshme, me kuotë, dhe kriteri për përcaktimin e kuotave ishte madhësia e komunës. Intervali i besimit është +/- 5. Në mostër, kishte gjithsej 54.7% meshkuj dhe 45.3% femra. Moshë mesatare e të anketuarve është 44 vjeç. Me arsim fillor ishin 14.4% të të anketuarve, 62.1% me arsim të mesme dhe 23.5% me arsimin të lartë, pra fakultet. Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, 25.9% janë të punësuar në sektorin publik, 22.3% në sektorin privat, 35.2% janë të papunë, ndërsa 16.6% janë në pension. Është e rëndësishme të theksohet se duke pasur parasysh faktin se nuk ka statistika zyrtare mbi strukturën demografike të popullsisë së synuar, pra të popullsisë serbe në Kosovë, vetëm kushtimisht mund të flasim për përfaqësim të mostrës.

Metodologjia dhe dizajni i kërkimit cilësor

INTERVISTAT

Periudha:

Hulumtimi u realizua nga muaji prill deri në nëntor 2020.

Instrumenti i hulumtimit:

Udhëzues për intervistë me 37 pyetje

Numri i përgjithshëm i të intervistuarve:

40

Kriteret për përzgjedhjen e bashkëbiseduesve:

vendbanimi, profesioni, gjinia


Bashkëbiseduesit:

përfaqësues të sektorit privat dhe publik, dhe përfaqësues të institucioneve financiare

3. Rezultatet e hulumtimit

Ekonomia e komunitetit serb në Kosovë përbëhet nga

6.440
NDËRMARRJE



Aktiviteti ekonomik dominues është **shitja me pakicë dhe shumicë**. Numri më i madh i subjekteve ekonomike është regjistruar në Leposaviq dhe më i vogli në Partesh.

Në tremujorin e tretë të vitit 2020 janë regjistruar

25%
më shumë subjekte të reja ekonomike sesa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Struktura e ekonomisë së komunitetit serb në Kosovë

Pas konfliktit të vitit 1999, struktura e popullatës serbe në Kosovë ndryshoi dukshëm.

Komunat me shumicë serbe ishin fillimisht Zveçani, Zubin Potoku, Shtërpca dhe Leposaviqi. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, procesi i decentralizimit bazuar në Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave në vitin 2009 themeloi gjashtë komuna të reja me shumicë Serbe, si në vijim: Mitrovica e Veriut, Graçanica, Novobërda, Ranillugu, Parteshi dhe Kllokoti.⁶ Gjeografikisht, Mitrovica e Veriut, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi janë katër komuna të vendosura në veri të Kosovës, ndërsa gjashtë komunat e tjera i përkasin territori në jug të lumit Ibër.

Duke qenë se serbët në katër komuna në veri të Kosovës bojkotuan regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, nuk ka të dhëna të sakta të numrit të popullsisë në komunat e vëzhguara. Bazuar në të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe vlerësimet e OSBE-së për popullsinë në veri të Kosovës, ka rreth 113,000 banorë në këto 10 komuna, ku 91,000 janë serbë të Kosovës. Dendësia më e

⁶ Ligji Nr. 03/L - 041- për Kufijtë Administrativ të Komunave, Gazeta Zyrtare e Kosovës, i qasshëm në <https://bit.ly/2WNerv3>

madhe e popullsisë është në Mitrovicën e Veriut me 2,678 banorë për km², kurse me dendësi më të vogël është komuna e Leposaviqit me vetëm 25 banorë në km².

Statistikat demografike të biznesit kanë një shpërndarje pak më të ndryshme sipas komunave. Sipas të dhënave të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, në periudhën prej vitit 2000 deri në nëntor 2020, në komunat e vëzhguara janë regjistruar 6,440 subjekte ekonomike, që është mesatarisht 5.7 subjekte ekonomike në 100

banorë. Numri më i madh i ndërmarrjeve është regjistruar në komunën e Leposaviqit dhe pastaj në Graçanicë. Nga ana tjetër, numri më i vogël i bizneseve operon në komunën e Parteshit, vetëm 10. Kjo është gjithashtu komuna më e vogël në mesin e dhjetë komunave me shumicë serbe, si për nga popullsia, ashtu edhe për nga sipërfaqja në të cilën shtrihet. Të dhënat për numrin e përgjithshëm të banorëve sipas komunave, madhësisë së tyre dhe numrit të subjekteve ekonomike të regjistruara nga viti 2000 deri në nëntor 2020 janë dhënë në tabelën vijuese.

Tabela 1. Dendësia e popullsisë dhe dendësia e subjekteve ekonomike në komunaa


Opština	Sipërfaqja (km ²)	Numri i banorëve	Dendësia e popullsisë për km ²	Numri i ndërmarrjeve	Dendësia e ndërmarrjeve për 100 banorë
Mitrovica e Veriut	11	29,460	2,678	727	2.47
Zveçan	122	16,650	136	874	5.25
Leposaviq	750	18,600	25	1,482	7.97
Zubin Potok	335	15,200	45	664	4.37
Graçanicë	131	10,675	81	1,245	11.66
Shtërpca	247	6,949	28	970	13.96
Novobërdë	204	6,729	33	418	6.21
Partesh	18.3	1,787	98	10	0.56
Klllokot	24	2,556	107	30	1.17
Ranillug	77.6	3,866	50	20	0.52
Totali	1,920	112,469	58.6	6,440	5.7

Burimi: InTER, bazuar në të dhënat nga Profilet komunale, Misioni i OSBE-së në Kosovë (Municipal profiles, OSCE Mission in Kosovo), shtator 2015 dhe të dhënat nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK)

Ndërmarrjet e regjistruara në periudhën nga viti 2000 deri në nëntor 2020 kryejnë veprimtari të ndryshme afariste. Sipas statistikave të subjekteve ekonomike në Kosovë, të harmonizuara me Klasifikimin e Veprimtarive Ekonomike në Bashkimin Evropian - NACE ⁷, veprimtaritë e regjistruara ekonomike në komunat në Kosovë janë të grupuara në 21 sektorë.⁸ Veprimtaria më e përfaqësuar është tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave me 2,386 ndërmarrje të regjistruara, që përbën 37% të subjekteve totale të regjistruara. E dyta është bujqësia, pylltaria dhe peshkataria me 966 subjekte ekonomike dhe një pjesëmarrje prej 15% në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik. Pastaj industria e përpunimit me 788 ndërmarrje të regjistruara (12.2%), shërbimet e akomodimit dhe hotelerisë (470 ndërmarrje, 7.3%) dhe ndërtimtaria (421 ndërmarrje, 6.5%). Veprimtaritë e tjera ekonomike të identifikuara përfaqësohen në një masë më të vogël, gjë që mund të shihet në Grafiku 1 në vijim.

Lidhur me shpërndarjen e ndërmarrjeve sipas komunave në veri dhe jug, ajo nuk është mjaft uniforme. Nga numri i përgjithshëm i subjekteve ekonomike të regjistruara, 3,747 janë regjistruar në komunat në veri të Kosovës, që përfaqëson 58% të totalit të regjistruar, ndërsa pjesa tjetër prej 42% janë subjekte ekonomike që operojnë në gjashtë komunat e tjera në jug që janë objekt i këtij hulumtimi. Gjithashtu, nuk ka dallime të konsiderueshme në aspektin e përfaqësimit të veprimtarive ekonomike, kështu që në komunat në veri, si dhe në

komunat e vëzhguara në jug të Kosovës, tri veprimtari më të përfaqësuara janë *tregtia me shumicë dhe pakicë, bujqësia, pylltaria dhe peshkataria dhe industria e përpunimit*. Kur bëhet fjalë për veprimtari tjera, gjithashtu, në shumicën e rasteve, më shumë ndërmarrje janë regjistruar në veri. Ka përjashtime të tilla si p.sh. veprimtaria e *akomodimit dhe shërbimeve të hotelerisë*, ku në komunat në jug ka pothuajse dy herë më shumë ndërmarrje të veprimtarisë së tillë. Gjithashtu, ka më shumë subjekte ekonomike në fushën e *artit, zbavitjes dhe rekreacionit* në komunat në jug të lumit Ibër.



Nga numri i përgjithshëm i subjekteve ekonomike të regjistruara

3.747, janë regjistruar në komunat në veri të Kosovës, që përfaqëson


58% të totalit të regjistruar, ndërsa pjesa tjetër prej

42% janë subjekte ekonomike që operojnë në gjashtë komunat e tjera në jug që janë objekt i këtij hulumtimi.

7 NACE – Klasifikimi i Veprimtarive Ekonomike në Bashkimin Evropian (Statistical classification of economic activities in the European Community)

8 1. Bujqësia, pylltaria, peshkataria; 2. Xehetaria; 3. Industria e përpunimit; 4. Furnizim me energji elektrike, gaz, avull, ajër të kondicionuar; 5. Furnizim me ujë, veprimtaritë e menaxhimit të ujërave të zeza, veprimtaritë e menaxhimit të mbeturinave dhe të ngjashme; 6. Ndërtimtaria; 7. Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave; 8. Transporti dhe magazinimi; 9. Shërbimet e akomodimit dhe hotelerisë; 10. Informimi dhe komunikimi; 11. Veprimtaritë financiare dhe të sigurimit; 12. Aktivitete të patundshmërive; 13. Veprimtaritë profesionale, shkencore, inovative dhe teknike; 14. Aktivitete administrative dhe shërbuese – mbështetëse; 15. Administrimi publik dhe mbrojtja; sigurimi i detyrueshëm social; 16. Arsimi; 17. Shëndetësi dhe punë sociale; 18. Administrimi publik dhe mbrojtja; sigurimi i detyrueshëm social; 19. Art, zbavitje dhe rekreacion; 20. Aktivitete të shërbimeve tjera; dhe 21. Aktivitete të ekonomive familjare si punëdhënës

Grafiku 1. Përfaqësimi i veprimtarive ekonomike në komunat me shumicë serbe në Kosovë, në %



Burimi: InTER, bazuar në të dhënat e ARBK-së për periudhën 2000 - 2020

Sipas të dhënave të ASK-së, në tremujorin e tretë të këtij viti, 2,593 ndërmarrje të reja janë regjistruar në të gjithë Kosovën, që është 8.9% më shumë se vitin e kaluar në të njëjtën periudhë. Në të njëjtën kohë, 27.5% më shumë se në tremujorin e dytë.⁹ Trendi i rritjes së numrit të ndërmarrjeve të reja është regjistruar edhe në komunat serbe në Kosovë, ku 65 ndërmarrje të reja janë themeluar në tremujorin e tretë të këtij viti, që është një rritje prej 25% krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar. Në tremujorin e tretë, kishte rreth 75% më shumë regjistrime të reja krahasuar me tremujorin e dytë të këtij viti, kur u regjistruan 37 ndërmarrje. Numri më i madh i ndërmarrjeve të reja është regjistruar në komunën e Graçanicës, pasuar nga Zubin Potoku, Leposaviqi dhe Novobërda. Në anën tjetër, në tremujorin e tretë të këtij viti, në komuna me shumicë serbe në Kosovë gjithsej 9 ndërmarrje u mbyllën, ndërsa në vitin 2020 u mbyllën 20 ndërmarrje. Krahasuar me vitin e kaluar, kur në këto komuna gjithsej 28 ndërmarrje ishin mbyllur, këtë vit ka 28.6% më pak ndërmarrje të mbyllura. Sidoqoftë, nuk ka statistika të disponueshme se sa ndërmarrje kanë pezulluar veprimtaritë e tyre në një periudhë të caktuar që nga fillimi i pandemisë COVID-19, duke pasur parasysh masat e rrepta për sektorin afarist që ishin në fuqi në muajt e parë pas shpalljes së pandemisë.

Bazuar në të dhënat e mbledhura përmes intervistave me subjektet ekonomike, pezullimi i aktiviteteve ishte i lidhur ngushtë me masat kundër përhapjes së koronavirusit të prezantuar nga qeveria e Kosovës, por edhe me sektorin e veprimtarisë së tyre. Hoteleria pësoi humbjet më të mëdha, sepse kufizimet e shumta fillimisht kishin të bënin me pezullimin e plotë të punës në objektet hoteliere, dhe më vonë me orarin e kufizuar të punës, duke respektuar masat e duhura epidemiologjike. Nga ana tjetër, ka veprimtari ekonomike të tilla si prodhimi i mobileve, ku pandemia ndikoi në rritjen e vëllimit të veprimtarisë dhe të ardhurave.

⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Bruto Produkti Vendor TM3 2020, i qasshëm në <https://bit.ly/3ruVPyq>

Punësimi në sektorin privat

Shkalla e lartë e papunësisë është një nga sfidat më të mëdha në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën. Sipas të dhënave të fundit të ASK-së, në fund të tremujorit të parë të vitit 2020, shkalla e papunësisë në Kosovë ishte 25.0%.¹⁰ Në Kosovë janë të punësuar 354,672 persona, që përfaqëson 29.1% të fuqisë punëtore aktive, shumica e të cilëve janë të punësuar në tregti (17.1%), prodhim (12.0%), arsim (10.7%) dhe ndërtimtari (10.6%). Të dhënat për ndryshimet në fuqinë punëtore në Kosovë të shkaktuara nga pandemia COVID-19 pas tremujorit të parë do të jenë në dispozicion në raportin përfundimtar për vitin 2020, duke pasur parasysh kufizimet në mbledhjen e rregullt të të dhënave nga terreni. Kur bëhet fjalë për punësimin në sektorin privat në 10 komuna me shumicë serbe në Kosovë, bazuar në të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës, në periudhën janar-tetor 2020 janë regjistruar 9,805 punëtorë. Numri i punëtorëve të regjistruar sipas komunave është i paraqitur në tabelën në vijim.













Sidoqoftë, nuk ka statistika të disponueshme se sa ndërmarrje kanë pezulluar veprimtaritë e tyre në një periudhë të caktuar që nga fillimi i pandemisë COVID-19, duke pasur parasysh masat e rrepta për sektorin afarist që ishin në fuqi në muajt e parë pas shpalljes së pandemisë.

Një devijim i dukshëm vërehet në komunën e Graçanicës, ku operojnë 1,245 ndërmarrje, dhe në territorin e së cilës janë regjistruar mbi 8,000 punëtorë. Kjo komunë, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë të vitit 2011, ka gjithsej 10,675 banorë. Sido-

¹⁰ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Anketa e fuqisë punëtore TMI 2020, e qasshme në <https://bit.ly/37OADeH>

Tabela 2. Numri i punëtorëve të regjistruar në sektorin privat sipas komunave

Komuna		Numri i punëtorëve të regjistruar
Mitrovica e Veriut		370
Zveçan		111
Leposaviq		169
Zubin Potok		98
Graçanicë		8,150
Shtërpçë		303
Novobërdë		196
Partesh		189
Kllokot		200
Ranillug		19

Burimi: InTER, bazuar në të dhënat nga Administrata Tatimore e Kosovës

qoftë, sipas raportit të fundit të ASK-së, mesatarisht 66% e popullsisë së Kosovës është aftë për të punuar, që përfaqëson 2/3 e popullsisë së përgjithshme. Nëse e zbatojmë atë në shembullin e komunës së Graçanicës, kjo do të thotë se numri i popullsisë të aftë për të punuar në këtë komunë është 7,117, që është më pak se numri i punëtorëve të regjistruar në sektorin privat. Kjo në të vërtetë do të thotë se nëse 100% e popullsisë të aftë për punë nga kjo komunë do të punësohej në sektorin privat, ky numër nuk do të jetë i barabartë me numrin e punëtorëve të regjistruar. Kjo mund të shpjegohet me punësimin e punëtorëve që nuk jetojnë në këtë komunë, ose me statistika të pasakta.

Sa i përket komunave të tjera, me përjashtim të komunës së Graçanicës, numri i punëtorëve të regjistruar në raport me numrin e ndërmarrjeve të regjistruara është mesatarisht 3.1 punëtorë për ndërmarrje, gjë që nuk devijon nga statistikat se 98.8% e ndërmarrjeve në Kosovë i përkasin kategorisë së ndërmarrjeve mikro (1-4 të punësuar).¹¹ Sidoqoftë, kur komunat merren parasysh veçmas, ka devijime

të konsiderueshme në komunat në veri krahasuar me komunat në jug. Edhe pse një numër më i madh i subjekteve ekonomike janë të regjistruar në komunat në veri të Kosovës në krahasim me komunat në jug, një numër më i madh i punëtorëve janë të regjistruar në komunat në jug. Kështu, në komunat në jug me 907 punëtorë të regjistruar, numri mesatar i punëtorëve për ndërmarrje është 5.5, ndërsa në veri mesatarja është dukshëm më e ulët dhe arrin në 0.2 punëtorë për ndërmarrje.¹² Në mesin e të komunave në jug, dallohet komuna e Parteshit, e cila punëson gjithsej 189 punëtorë (18,9 punëtorë për ndërmarrje) nga vetëm 10 subjekte ekonomike të regjistruara.

Me një dallim kaq drastik midis veriut dhe jugut, krijohet përshtypja se ndërmarrjet në veri të Kosovës shumë rrallë raportojnë punëtorët e tyre në Administratën Tatimore të Kosovës ose një numër i madh i ndërmarrjeve të regjistruara nuk janë aktive. Nëse bëhet fjalë për mos regjistrim të punëtorëve, kjo dukuri mund të shpjegohet me faktin se komunat me shumicë serbe në jug filluan të funksionojnë brenda sistemit juridik të Kosovës shumë më herët sesa

¹¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë, TM3 2020, i qasshëm në <https://bit.ly/3ruVPyq>

¹² Nëse përjashtohet komuna e Graçanicës, për shkak të paqartësisë në lidhje me numrin e regjistruar të punëtorëve në sektorin privat

komunat në veri, duke integruar kështu sektorin privat në sistemin juridik të Kosovës dhe duke respektuar më shumë detyrimet ligjore në sektorin ekonomik.

Sfidat e subjekteve ekonomike të komunitetit serb në Kosovë në të bërit biznes

Problemet e përgjithshme të të bërit biznes

Për shkak të problemeve të ndryshme politike, të sigurisë dhe ekonomike, si dhe për shkak të mungesës së sundimit të ligjit, veçanërisht në veri të Kosovës, është krijuar një sistem në të cilin afaristët në komunat me shumicë serbe janë në një pozitë të pa lakmueshme. Ata e vlerësojnë mjedisin e tyre të biznesit kryesisht si të mirë, por ekziston një gamë e gjerë e problemeve dhe pengesave që afaristët nga komunat e vëzhguara hasin në veprimtarinë e tyre afariste.

Kur bëhet fjalë për pengesa administrative dhe ligjore me të cilat përballen afaristët në komunitetet serbe, ato më shpesh i referohen importit, eksportit dhe tranzitit të mallrave, dhe herë pas here disponueshmërisë së ligjeve, vendimeve, procedurave dhe të ngjashme në gjuhën serbe. Këto janë të njëjtat probleme që u identifikuan në mesin e afaristëve në veri të Kosovës në hulumtimin e realizuar gjatë vitit 2017.¹³ Sidoqoftë, për sa i përket procedurave në lidhje me regjistrimin dhe menaxhimin administrativ të biznesit, afaristët zakonisht i vlerësojnë ato si shumë të thjeshta dhe jo problematike.

Stigmatizimi i bizneseve është një nga problemet në listë, ose kur bëhet fjalë për bashkëpunim ndërtnik (nuk është e popullarizuar që shqiptarët të blejnë mallra nga bizneset e komuniteti serb), ose kur bëhet fjalë për komunitetin e tyre, ku koncepti i të bërit biznes që nënkupton bashkëpunimin midis ndërmarrjeve serbe dhe shqiptare akoma nuk është pranuar

plotësisht. Prandaj, përkundër faktit se tregu i vogël është një nga sfidat e shpeshta në të bërit biznes, subjektet ekonomike nga zonat me shumicë serbe shumë shpesh bëjnë biznes vetëm në territorin e komunës së tyre, gjë që është veçanërisht rasti për bizneset në veri të Kosovës. Mosnjohja e gjuhës së komunitetit tjetër është gjithashtu një pengesë për zgjerimin e bashkëpunimit, kështu që në situata të caktuara, përkundër parakushteve të mira, hiqet dorë nga bashkëpunimi. Ka shembuj ku sigurimi i lëndëve të para për operacione të rregullta afariste është më i përballeshëm në tregun e Kosovës, por për shkak të problemit të lartcekur, nuk është e lehtë të gjesh një partner afarist dhe të biesh dakord për bashkëpunim.

Përkundër faktit se ndërmarrjet e sektorit privat në mjediset serbe në Kosovë zakonisht nuk kërkojnë staf shumë të aftë, afaristët përballen me një sfidë në gjetjen e një fuqie punëtore të përshtatshme. Një nga arsyt është kualifikimi joadekuat i punëtorëve për punë në treg, ndërsa tjetra qëndron në problemin ekonomik, pra pagat e ulëta në sektorin privat. Prandaj, nuk është e pazakontë që të papunët të mos dëshirojnë të punojnë me paga të ulëta të ofruara nga ekonomia, ose të gjejnë mundësi jashtë tregut të punës të komunave serbe në Kosovë.

Në mjediset me shumicë serbe në Kosovë, ndërmarrjet zakonisht nuk janë anëtare të ndonjë shoqate apo ode ekonomike, dhe kjo praktikë është veçanërisht e përhapur në mesin e ndërmarrjeve të regjistruara në veri të Kosovës. Natyra e biznesit të tyre është e organizuar në mënyrë të tillë që të mos ketë orientim drejt veprimit kolektiv, dhe për këtë arsye ka mungesë të përfaqësimit dhe anëtarësimit në shoqatat e biznesit. Ambienti i pasigurt në të cilin operojnë dhe mungesa e planifikimit afatgjatë nënkupton ndërmarrjet nga komunat e vëzhguara nuk kanë përfitime të mundshme nga rrjetet, shoqatat e biznesit dhe ngjarjet e biznesit.

Në komunat e vëzhguara, posaçërisht në veri të Kosovës, shpesh ndodh që bizneset të veprojnë në dy sisteme, d.m.th. të kenë regjistruar veprimtarinë në sistemin juridik të Kosovës dhe të Serbisë. Sidoqoftë, shumica e afaristëve me të cilët janë kryer intervista të hollësishme, në vitet e fundit, kanë funksionuar

13 Frikonomia e veriut të Kosovës, InTER 2017, i qasshëm në <https://bit.ly/3aPTQIk>

kryesisht në kuadër të sistemit kosovar. Arsyeja për këtë është se lehtëson veprimtarinë e tyre, si dhe bashkëpunimin me subjektet ekonomike në jug, ndërsa ndërmarrjet e regjistruara në sistemin serb përdoren më shpesh për faturimin e shërbimeve ndaj subjekteve që veprojnë në sistemin serb. Kompanitë që marrin pjesë në tenderë publik në institucione serbe aktivitetin më të madh e kanë brenda sistemit juridik serb në Kosovë. Afaristët që bëjnë biznes në dy sisteme zakonisht e konsiderojnë atë më shumë si një kosto sesa një avantazh, sepse kërkon llogari të dyfishtë, gjë që rrit kostot e biznesit, të cilat rezultojnë me rritjen e çmimit të një produkti ose shërbimi. Kjo në fund të fundit vë në pikëpyetje konkurrencën e tyre në treg.

Kriza e shkaktuar nga pandemia COVID-19 preku subjektet ekonomike në zonat me shumicë serbe të Kosovës duke përshtatur veprimtarinë e tyre në rrethanat e reja. Nëse ata do ndërpresin punën, mbajnë të njëjtin shtrirje apo zgjerojnë veprimtarinë e tyre, varet kryesisht nga aktiviteti i biznesit. Hoteleria është një nga veprimtaritë me humbjet më të mëdha, duke pasur parasysh masat e shumta kufizuese të Qeverisë së Kosovës në lidhje me pezullimin e plotë të objekteve hoteliere për një periudhë të caktuar kohore, dhe më vonë me kufizimet e rrepta në numrin e mysafirëve, punën me kohë të pjeshme dhe kërkesat për pajtueshmëri me masat parandaluese shëndetësore. Bizneset e tjera më së shumti realizojnë aktivitetin e tyre në një shkallë të reduktuar, ndërsa ka shembuj që, përkundër pandemisë COVID-19, vazhduan me vëllim të njëjtë të punës, dhe këto janë kryesisht dyqane tregtare, pra tregtia e mallrave të konsumit. Përveç kësaj, prodhimi i mobileve është një shembull i shkëlqyeshëm i të bërit biznes gjatë pandemisë, sepse afaristët e kësaj veprimtarie arritën një vëllim dukshëm më të lartë të biznesit në krahasim me periudhën para pandemisë.

Problemet e shkaktuara nga futja e taksave prej 100% dhe parimi i reciprocitetit

Në marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, në retrospektivë, sfida dhe tensione të shumta janë ngrihur gjatë viteve në fusha të ndryshme, veçanërisht në

fushën e tregtisë. Ndër të fundit ishte rezultati i vendimit të Qeverisë së Kosovës të datës 6 nëntor 2018 për të rritur taksën për importin e mallrave nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina me 10% me arsyetim të mbrojtjes së tregut të vendor. Situata u ndërlikua më tej pas aplikimit të dështuar të Kosovës për pranim në INTERPOL, kur qeveria e Kosovës fajësoi Serbinë për dështimin e saj dhe rriti taksën fillestare prej 10% në 100%. Taksat qëndruan në fuqi deri në mars të vitit 2020, kur filloi heqja graduale e tyre. Fillimisht, u shfuqizua taksa mbi importet e lëndëve të para nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina, dhe më vonë më 1 prill, hyri në fuqi vendimi i Qeverisë së Kosovës, i cili shfuqizoi plotësisht taksat me futjen e disa masave të reciprocitetit për Serbinë por që nuk vlejnin për importet nga Bosnja dhe Hercegovina.

Masat e reciprocitetit nënkuptojnë që në marrëdhëniet tregtare me Serbinë, termat e përdorur në dokumentet e nevojshme duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe legjislacionin në fuqi, dhe se emërimet që mohojnë pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës nuk lejohen. Kjo i referohet kryesisht certifikatave fitosanitare dhe dokumentacionit përcjellës për ushqime dhe produkte jo-ushqimore me origjinë bimore dhe jo-shtazore që i nënshtrohen kontrollit fitosanitar në kufi, dhe certifikatave fitosanitare dhe dokumentacionit përcjellës për ushqime dhe produkte jo-ushqimore me origjinë shtazore që i nënshtrohen kontrollit veterinar në kufi.¹⁴ Përveç kësaj, gjatë majit, qeveria e Kosovës aktivizoi një vendim të mëparshëm mbi taksat speciale për importin e miellit dhe blloqeve ndërtuese nga Serbia qendrore, kështu që një kilogram miell tani ngarkohet me katër cent, dhe një bllok me dy cent. Në këtë mënyrë, importi i miellit dhe blloqeve ndikohet drejtpërdrejt për shkak të logjikës jo-ekonomike për importuesin, përkatësisht çmimit jo-konkurrues të këtyre produkteve serbe në tregun e Kosovës.

Futja e barrierave për import, duke filluar me taksat dhe masat e reciprocitetit ndaj Serbisë, ka qenë një sfidë për një numër prodhuesish në Kosovë, për shkak të varësisë së tyre për lëndët e para që vijnë nga Serbia, si dhe për importuesit e produkteve gatshme.

¹⁴ Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. 01/20, i qasshëm në <http://bit.ly/2WK6xCH>

Përveç nevojës për të zëvendësuar produktet e importuara nga Serbia, ndërmarrjet janë përballur me rritje të kostove të transportit. Sidoqoftë, për ndërmarrjet e tjera lokale nga komunat me shumicë serbe të Kosovës që importojnë nga vendet e tjera ose kanë vendosur tashmë bashkëpunim me furnitorët nga Kosova, taksat nuk patën ndikim të konsiderueshëm në punën e tyre.

Sfida dhe ndryshime të reja në fushën e biznesit janë krijuar për afaristët në komunitetet serbe në Kosovë, biznesi i të cilëve është i lidhur drejtpërdrejt me importin e lëndëve të para dhe produkteve të gatshme nga Serbia. Disa lëndë të para mund të blihen nga distributorët në Kosovë, por me çmime më të larta, qofshin ato lëndë të para me origjinë nga Serbia apo vendet e tjera. Ndërsa produktet zëvendësuese me origjinë nga Kosova, mund të sigurohen me çmime të volitshme, por me cilësi dukshëm më të ulët. Gjithashtu, që nga vendosja e taksës, disa produkte me origjinë serbe nuk kanë qenë fare në treg, dhe nga ana tjetër, ka pasur rezistencë në komunitetin serb për zëvendësimin e këtyre produkteve me ato të prodhuesve kosovarë. Në raste të tilla, bizneset u përballën me humbje të konsiderueshme operative, gjë që u reflektua me reduktim të punëtorëve në ndërmarrjet e tyre.

Përdorimi i fondeve të masave për të luftuar pasojat ekonomike të shkaktuara nga pandemia COVID-19

Masat e para parandaluese për të mbrojtur popullsinë nga koronavirusi u miratuan në Kosovë më 11 mars të këtij viti, para se të konfirmohej një rast pozitiv.¹⁵ Përveç masave të përgjithshme të miratuara për të mbrojtur shëndetin e popullsisë dhe për të parandaluar përhapjen e koronavirusit, Qeveria e Kosovës në prill miratoi një Pako Fiskale Emergjente për të siguruar, përveç shëndetit të popullsisë, edhe shëndetin e ekonomisë.

¹⁵ Ministria e Shëndetësisë e Kosovës konfirmoi rastin e parë të infektuar me koronavirus më 13 mars 2020.

Pako fiskale emergjente (PFE) përmbante 15 masa dhe nuk kishte për qëllim një politikë afatgjate për të inkurajuar rimëkëmbjen ekonomike, sepse, siç vërehet nga emërtimi, ajo u miratua kur Kosova u gjend në një situatë të papritur të pafavorshme shëndetësore.¹⁶ PFE është krijuar për të siguruar ndihmë financiare shtesë për pjesët më të varfra të shoqërisë pas pandemisë COVID-19; të mbështesë bizneset në mbulimin e kostove operative për të siguruar një pagë minimale për të gjithë punëtorët gjatë gjendjes së jashtëzakonshme; si dhe për të ofruar mundësi për vazhdimësinë e punës së bizneseve gjatë dhe pas tejkalimit të gjendjes emergjente.



Mbi 30,000 ndërmarrje në Kosovë u mbështetën përmes Pakos së Ndihmës Fiskale Emergjente për pasojat ekonomike të shkaktuara nga pandemia e COVID-19. Nga komunat me shumicë serbe në Kosovë janë **mbështetur 781 ndërmarrje.**

Nga gjithsej 15 masa të PFE-së, njëra prej tyre (numri 3) i referohej mbështetjes së drejtpërdrejtë për sektorin privat. Sektori privat u mbështet gjithashtu përmes dy masave të tjera (nr. 10 dhe 14) të stimulimit ekonomik. Masa 3 përcakton mbulimin e shpenzimeve të pagave mujore të punonjësve në vlerë prej 170 EUR për periudhën prill - maj 2020. Shuma totale e kësaj mase ishte 41 milion EUR. Përveç pagave të mbuluara, përcaktohet që Qeveria do të paguajë kontributet përkatëse pensionale për atë periudhë në shumën totale prej 8 milion EUR. Kjo masë parashikon gjithashtu një subvencion të qirasë deri në 50% të qirasë mujore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, për peri-

¹⁶ Ministria e Financave e Kosovës, Plani operacional për Pakon Fiskale Emergjente, Prill 2020, i qasshëm në <https://bit.ly/3mTeVui>

udhën prill - maj 2020, për të cilën është caktuar shuma prej 12 milion EUR.

Në mënyrë që ndërmarrjet të jenë përfituese të mbështetjes së përcaktuar përmes Masës 3, atyre u është dashur të plotësojnë disa kritere të tilla si të provojnë se vendimet e Qeverisë kanë ndikuar në uljen e të ardhurave të tyre përmes bilancit bankar dhe të ofrojnë prova tjera të ngjashme. Punëdhënësi pritej të përdorte sistemin elektronik EDI,¹⁷ jo më vonë se data 15 maj 2020, të plotësonte dhe dërgonte formularin dhe dokumentacionin e siguruar nga Administrata Tatimore e Kosovës. Për më tepër, punonjësit mund të ishin përfitues nëse ishin të regjistruar në listën e pagave të punëdhënësit për muajin shkurt 2020 dhe nëse kishin një llogari bankare të vlefshme në njërin nga bankat e licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës. Kishte një përjashtim nga ky kriter, i cili i referohej faktit që punonjësi mund të ishte përfitues i subvencionit nga kjo masë nëse nuk ishte në listën e pagave të punëdhënësit në shkurt të vitit 2020, por ishte punësuar në mars, në bazë të një kontrate pune më

së paku një vjeçare. Mbulimi mujor i pagave nga kjo masë është paguar drejtpërdrejt nga Thesari në llogarinë e punonjësve, në mënyrë që punëdhënësi të mos ishte ndërmjetës në pagesa. Përjashtime ka në situata në të cilat ndërmarrjet kishin paguar plotësisht pagat për muajin mars, pavarësisht nga vështirësitë financiare. Në këtë rast, pagat prej 170 EUR për punonjësit u kredituan në llogarinë e punëdhënësit si rimbursim i shpenzimeve.

Kur bëhet fjalë për subvencionin për qira deri në pesëdhjetë përqind (50%) të vlerës së qirasë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për muajt prill dhe maj, për përfituar nga kjo masë, ishte gjithashtu e nevojshme të plotësoheshin disa kritere. Qiramarrësi duhej të provonte se biznesi i tij ishte prekur direkt ose indirekt nga situata emergjente e shkaktuar nga pandemia COVID-19, se kishte një marrëveshje qiraje të lidhur para 1 marsit 2020 dhe të paraqiste formularët e nevojshëm dhe dokumentacionin tjetër përmes sistemit elektronik EDI brenda afatit të paraparë.

Tabela 3. Numri i bizneseve përfituese të Masës 3 të Pakos Fiskale Emergjente, sipas komunave

Komuna	Numri i përfituesve të Masës 3 të PFE-së	Numri i subjekteve ekonomike të regjistruara
Mitrovica e Veriut	34	727
Zveçan	20	874
Leposaviq	34	1,482
Zubin Potok	8	664
Graçanicë	415	1,245
Shtërpcë	110	970
Novobërdë	47	418
Partesh	66	10
Kllokot	40	30
Ranillug	7	20
Totali	781	6,440

Burimi: InTER, bazuar në të dhënat nga Administrata Tatimore e Kosovës

¹⁷ Emërtimi i sistemit të deklarimit elektronik të Administratës Tatimore të Kosovës

Sipas të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës, për dhënien e subvencioneve nga Masa 3 e përshkruar në PFE, përfituan gjithsej 781 ndërmarrje nga dhjetë komunat e vëzhguara në Kosovë. Më së shumti aplikacione janë aprovuar për komunën e Graçanicës (415), dhe më së paku për komunën e Ranillugut (7). Ngjashëm me numrin e punëtorëve të regjistruar, shpërndarja e subvencioneve për komunat në veri dhe në jug ishte jo e barabartë. Më saktësisht, nga gjithsej 781 ndërmarrje për të cilat ishin alokuar fonde nga Masa 3, vetëm 96 (12.3%) ishin regjistruar në komunat në veri të Kosovës (shih Tabelën 3).

Sa i përket vetë procesit të aplikimit, është shumë e rëndësishme të përmendet se, bazuar në vlerësimet e përfaqësuesve të sektorit privat në komunat në veri dhe jug të Kosovës, procedurat ishin shumë të qarta, dokumentacioni ishte në dispozicion në gjuhën serbe dhe sistemi elektronik për dorëzimin e formularëve të kërkuar funksionoi shumë mirë. Në atë kuptim që, nëse ndërmarrjet plotësonin kushtet, nuk do të kishte pengesa domethënëse administrative për të para-shtruar aplikacione për subvencione.

Lidhur me masat stimuluese ekonomike, dy masa tjera janë identifikuar në PFE për sektorin privat:

MASA 10 - Sigurimi i likuiditetit financiar për dy kategori - (a) Mikro-ndërmarrjet dhe të vetë-punësuarit nëpërmjet programeve të caktuara të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, në shumën deri në 10,000 EUR për një periudhë prej 2 vjet, në vlerë deri në 15 milion EUR; - (b) Shoqëritë tregtare/Kompanitë e autorizuara që ofrojnë shërbime bazike (të ngjashme me ato të ndërmarrjeve publike) me një rimbursim deri më 31.12.2020 në kuadër të vlerës së përcaktuar në pikën 1.4. të Vendimit të PFE;

MASA 14 - Mbështetje financiare për shoqëritë tregtare që regjistrojnë punëtorët me një kontratë pune së paku një vjeçare gjatë periudhës së situatës së jashtëzakonshme, nga 130 euro për dy muajt pasues pas regjistrimit, në shumën totale deri në 6 milion EUR.

Përveç ndihmës financiare nga Masa 10, Masa 14 kishte për qëllim rritjen e punësimit formal, pasi ishte e dedikuar për ndërmarrjet që rregullisht

regjistrojnë punëtorët me një kontratë pune prej të paktën një viti. Në kohën e realizimit të hulumtimit, nuk kishte të dhëna nga Administrata Tatimore e Kosovës se sa përfitues nga 10 komuna me shumicë serbe në Kosovë kishin aplikuar për këto dy masa mbështetëse.

Sidoqoftë, përkundër vendimit që PFE u miratua në fillim të prillit, deri në qershor ishte realizuar vetëm një e treta e fondeve nga Pako Fiskale Emergjente. Arsyet për vonesat, përveç kapacitetit të kufizuar institucional, ishin të natyrës burokratike, fiskale dhe politike. Ligji për Buxhetin nga viti 2020 nuk parashi-konte kosto të tilla, kështu që në mungesë të fondeve të mjaftueshme për raste emergjente, buxheti kërkonte një rialokim dhe ndryshime të nevojshme ligjore. Kriza politike dhe ndryshimet në skenën politike gjithashtu kanë ndikuar negativisht në zbatimin e masave nga kjo pako mbështetëse.

Përveç PFE-së, Qeveria e Kosovës ka ndarë gjithsej 87 milion EUR në kuadër të Fondit të Rimëkëmbjes Ekonomike, i cili ka për qëllim të subvencionojë pagat në sektorin privat (60 milion EUR), pastaj për të ndihmuar familjet me ndihmë sociale (7.5 milion EUR), fermerët (12 milion EUR), ndërmarrësit (1 milion EUR), projektet e zhvillimit rajonal (1 milion EUR), institucionet kulturore (2.5 milion EUR), ndërmarrjet publike (1 milion EUR), familjet nga komunitetet jo-shumicë (1 milion EUR) dhe promovimin e punësimit të grave (1 milion EUR).¹⁸

Fondet e alokuara për ndërmarrjet për subvencionimin e pagave alokohen në varësi të numrit të të punësuarve. Procedurat për shpërndarjen e këtyre fondeve u thjeshtuan dhe ndërmarrjeve nuk iu kërkuar të raportojë në Ministrinë e Financave, por u përdor një kriter i bazuar në numrin e të punësuarve që kompania kishte në dhjetor të vitit 2019. Ky kriter u miratua sepse disa ndërmarrje mund të kenë zvogëluar numrin e të punësuarve për shkak të pandemisë COVID-19 dhe dhjetori u mor si muaji i fundit kur gjithçka funksionoi para shfaqjes së koronavirusit, si dhe u miratuan kriteret e njëjta për të gjithë. Kjo

¹⁸ Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. 10/33, i qasshëm në <https://bit.ly/37OCHDT>

masë subvencionit mbulon të gjitha kompanitë aktive që kanë të dhëna të përditësuara në sistemin EDI, të tilla si llogaria bankare e saktë, numri fiskal, etj. Sipas Ministrisë së Financave, pagesa mesatare për një ndërmarrje për punëtor është 290 EUR dhe paguhet drejtpërdrejt në llogarinë e punëdhënësit i cili mund t'i përdorë këto fonde për aktivitete që do t'i mundësojnë atij të tejkalojë më lehtë krizën e shkaktuar nga pandemia e COVID-19. Sipas fjalëve të zëdhënësit të Ministrisë së Financave të Kosovës, deri më 30 tetor, janë paguar fondet për 31,000 ndërmarrje në vlerë prej 57,304,976 EUR, ndërsa shuma e mbetur ishte e rezervuar për ndërmarrjet që nuk kanë regjistruar të dhëna të sakta në sistemin EDI, kështu që Ministria e Financave të Kosovës bëri thirrje për përditësimin e të dhëna në mënyrë që të realizohet pagesa.

Të gjitha subjektet ekonomike të përfshira në këtë hulumtim dhe që veprojnë në mënyrë aktive në sistemin juridik të Kosovës pranuan fonde nga kjo pako e mbështetjes ekonomike. Ata e vlerësuan këtë pako mbështetëse si të thjeshtë dhe jo-diskriminuese, për sa i përket përkatësisë etnike të përfituesve të mbështetjes, mirëpo gjithashtu pako do duhej të ishte e dedikuar më shumë për sektorët e caktuar në proporcion me prekjen nga masat për të luftuar pandeminë COVID-19. Sidoqoftë, fondet e aprovuara nënkuptonin shumë për bizneset dhe për subvencionimin e pagave për punëtorët e tyre, ndërsa një pjesë e fondeve ishin alokuar për investime me qëllim të përmirësimit të biznesit të tyre.

Qasja në institucionet financiare për zhvillimin e biznesit

Krijimi i mundësive më të mira afariste për ndërmarrjet është thelbësorë për zhvillimin e sektorit privat si në zona të tjera ashtu edhe në komunat me shumicë serbe në Kosovë. Një nga sfidat kryesore me të cilat afaristët përballen vazhdimisht janë mundësitë e kufizuara të financimit.

Shumica e ndërmarrjeve edhe më tutje mbështeten shumë në kapitalin e tyre vetanak për të investuar.

Përdorimi i kapitalit vetanak për investime është burimi më i zakonshëm i financimit, ndërsa në vendin e dytë janë kreditë bankare. Për qasje në marrëveshjet financiare me bankat komerciale, pra, për kreditim, bizneset në Kosovë duhet të plotësojnë disa kërkesa. Është e nevojshme që biznesi të jetë i regjistruar në kuadër të sistemit juridik të Kosovës, pastaj të bashkëngjitet një vërtetim për shlyerje të detyrimit tatimor, të sigurohet pengu për pronë të luajtshme, të sigurohet një kompani garantuese dhe të hapet një llogari bankare në bankën në të cilën aplikohet për fonde financiare.

Shumica e bizneseve vijnë me kërkesa për kredi biznesi të shumave më të vogla, ku kufiri i fondeve të aprovuara është pa hipotekë. Për shembull, në NLB Bankën këto kredi arrijnë shumën deri në 30 mijë euro. Kur bëhet fjalë për kreditë hipotekare, nuk ka shumë ndërmarrje të komunitetit serb që mund të hyjnë në marrëveshje më të mëdha. Nga ana tjetër, marrëdhëniet pronësore-juridike janë një problem që lind me rastin e aplikimit për kredi hipotekare në bankat komerciale në Kosovë, veçanërisht për bizneset në veri. Asetet e ndërmarrjeve në veri të Kosovës regjistrohen kryesisht në gjykata që deri vonë ishin nën juridiksionin e Republikës së Serbisë dhe të cilat nuk njihen nga institucionet e Kosovës.

Përveç vërtetimit të marrëdhënieve të përmendura pronësore-juridike, për marrjen e kredive, posaçërisht për ndërmarrjet në veri, problemi është gjithashtu vërtetimi i suksesit të biznesit, ku shpesh ndodh që ndërmarrjet të mos respektojnë të gjitha procedurat tatimore dhe të kontabilitetit, dhe të aplikojnë për tatim paushall. Në atë mënyrë, procedura e vërtetimit të aftësisë pagueuse dhe likuiditetit të ndërmarrjes është më e vështirë. Gjithashtu, edhe një specifikë tjetër e ndërmarrësve në veri të Kosovës është se ata nuk e zbatojnë sistemin fiskal, kështu që kontrolli i qarkullimit është i vështirë. Me rastin e vlerësimit për miratim të kredive, bankat shpesh kontrollojnë librat e tyre të brendshëm të blerjeve dhe shpenzimeve, dhe ndodh që disa banka në raste të caktuara të marrin parasysh qarkullimin e realizuar në sistemin serb.

Afaristët nga komuniteti serb përfitues të shërbimeve financiare nga bankat, kryesisht të kredive të vogla biznesi, e vlerësojnë qasjen në këto shërbime si të

mirë. Nga ana tjetër, as bankat nuk kishin probleme të mëdha me shlyerjen e kredive. Në rastin e kredive për ndërmarrjet tregtare, një veturë e regjistruar në sistemin kosovar shpesh merret si peng, për shkak të mundësisë së regjistrimit në regjistrin e kredive.

Kur bëhet fjalë për masa të veçanta të marra nga bankat gjatë pandemisë COVID-19, kishte një lehtësim në formën e një moratoriumi për shlyerjen e kredisë, me kushtin që moratoriumi të mos zbatohet si rregull për të gjithë përfituesit e kredisë, dhe për këtë personat juridikë dhe fizikë duhej të aplikonin në bankë.

Gjatë vitit 2020, shuma totale e kredive të aprovuara në bankat e Kosovës kishte rënie, veçanërisht në sektorin privat, por gjatë pjesës më të madhe të vitit kreditë për sektorin e hotelierisë, i cili përbën një pjesë të konsiderueshme të sektorit privat në zonat serbe në Kosovë, u pezulluan. Sipas të dhënave të disponueshme nga NLB Banka, gjatë vitit 2019, gjithsej 4,010,170 EUR për 912 kredi janë aprovuar në komunat në veri të Kosovës, nga të cilat vetëm 93,000 EUR (2.3%) janë aprovuar për personat juridikë. Gjatë vitit 2020, kishte një rënie të ndjeshme në fushën e kreditimit, kështu që në fund të nëntorit, u miratuan 2,708,510 EUR ose 567 kredi, nga të cilat vetëm një kredi biznesi u rifinancua në shumën prej 5,000 EUR.

Sipas NLB Bankës, gjendja në komunat në jug është më e mirë kur bëhet fjalë për kreditë e biznesit, kështu që në komunën e Shtërpçës portofoli i përgjithshëm i kredisë arriti në 2,777,889 EUR ose 866 kredi, nga të cilat 948,196 EUR, përkatësisht 34% ishin investuar në sektorin privat për gjithsej 48 ndërmarrje. Në komunën e Graçanicës, portofoli i kredisë në total arrin në 1,176,051 EUR ose 414 kredi, nga të cilat 728,800 EUR (afërsisht 62%) janë investuar në sektorin e biznesit. Nëse krahasojmë portofolin e kredive për sektorin privat në jug dhe veri, do të shohim se vetëm në Shtërpçë ka më shumë kredi biznesi aktive sesa në të katër komunat veriore së bashku. Arsyeja kryesore e më shumë kredive për sektorin e biznesit në zonat në jug është ekzistenca e një kornize ligjore për regjistrimin e pengut të nevojshëm, d.m.th. hipoteka e nevojshme për të gjitha investimet më të mëdha se 30,000 EUR.

Qasja në integrimin ekonomik në Kosovë

Në mënyrë që të përcaktohet shkalla në të cilën komuniteti serb nga dhjetë komunat me shumicë serbe në Kosovë është i hapur për integrimin e subjekteve ekonomike në ekonominë e Kosovës, u realizua një studim që përfshiu 582 të anketuar që u përgjigjën gjashtë pyetjeve me këtë temë. Rezultatet e hulumtimit sipas vendbanimit të të anketuarve janë grupuar në të anketuar në veri dhe jug të Kosovës. Siç është shpjeguar më herët në punim, komunat në veri janë komunat e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Leposaviqit dhe Zubin Potokut, ndërsa komunat në jug të Kosovës që janë objekt i këtij hulumtimi janë Graçanica, Shtërpça, Novobërda, Parteshi, Kllokoti dhe Ranillug.



Që marrëdhëniet ekonomike

ndërmjet ndërmarrjeve serbe dhe shqiptare në Kosovë duhet të forcohen e konsiderojnë

53% e të anketuarve.

Mbi 60% e të anketuarve nuk janë dakord me qëndrimin se nuk do të bënin biznes me shqiptarët pavarësisht fitimit që mund të realizohet në këtë mënyrë.

Mbi **65%**

e komunitetit serb pajtohet që nuk u intereson aspak nëse pronari i ndërmarrjes është shqiptar apo serb, por kush ofron një shërbim/produkt më të lirë dhe më të mirë. Në marrëdhënien e përgjithshme afariste midis serbëve dhe shqiptarëve ende më së shumti ndikon prezenca e mosbesimit të përgjithshëm ndërmjet këtyre dy komuniteteve, por gjithashtu barriera gjuhësore, pra mosnjohja e gjuhës së komuniteti tjetër.


1. Tregtia në mjediset tashmë me shumicë shqiptare ose në dyqane në pronësi të shqiptarëve

Kur pyeten se sa shpesh serbët nga komunat e synuara blejnë në zonat me shumicë shqiptare ose në dyqane në pronësi të shqiptarëve, përgjigjja mbizotëruese është disa herë në muaj, ndërsa përgjigja më pak e përfaqësuar është asnjëherë. Në lidhje me këtë çështje, ekziston një ndryshim i rëndësishëm në sjelljen konsumatorëve në veri dhe në jug, pra në jug ka dy herë më shumë konsu-

matorë që blejnë disa herë në javë në zonat me shumicë shqiptare, ndërsa në veri ka dy herë më shumë që e bëjnë këtë më rrallë, në krahasim me konsumatorët nga komunat në jug (Grafiku 2).

Duke pasur parasysh që tek preferenca e konsumatorëve modernë, afërsia e dyqanit luan një rol të rëndësishëm në përzgjedhje, rezultatet e marra në veri nuk tregojnë domosdoshmërisht shmangien e dyqaneve në pronësi të shqiptarëve të Kosovës, por mund të ndërlidhet me faktin se këto dyqane pothuajse nuk ekzistojnë në komunat veriore.¹⁹

Grafiku 2. Tregtia në mjediset me shumicë shqiptare ose në dyqane në pronësi të shqiptarëve



Burimi: Rezultatet e hulumtimit të gjendjes ekonomike të komunitetit serb në Kosovë

¹⁹ Përrjashtim është mahalla e Boshnjakëve, një vendbanim multi-etnik në Mitrovicën e Veriut.

2. Marrëdhëniet ekonomike midis serbëve dhe shqiptarëve

Bashkëpunimi ekonomik midis bizneseve të etnive të ndryshme është ndër format e para të bashkëpunimit në shkallë të gjerë i cili është zhvilluar pas konfliktit në Kosovë. Kështu sot, pjesëtarët e komunitetit serb nga komunat në veri dhe jug, besojnë se është e nevojshme të forcohen marrëdhëniet ekonomike midis serbëve dhe shqiptarëve, dhe qëndrimi i tillë mbahet nga shumica e të anketuarve, pavarësisht nga mosha. Rreth 15% e popullsisë nga komunat e vëzhguara ende kanë një qëndrim negativ ndaj kësaj çështje, që është njësoj i pranishëm në veri dhe jug, por disi më shumë tek të moshuarit, pra midis të anketuarve mbi moshën 50 vjeçare.

Mbi 60% e të anketuarve nuk janë dakord me qëndrimin se ata nuk do të bënin biznes me shqiptarët pavarësisht fitimit që në këtë mënyrë mund të realizohet, 12% kanë një qëndrim neutral, ndërsa 22% besojnë se fitimi nuk justifikon të bërit biznes me anëtarët e komunitetit shqiptar. Në lidhje me këtë çështje, nuk ka dallime drastike në përgjigjet midis të anketuarve në veri dhe jug, përveç për mospërputhje të vogla në përgjigjet që shkojnë në ekstrem me pajtueshmërinë e plotë, përkatësisht mos pajtueshmërinë e plotë me qëndrimin e dhënë. Në atë kuptim, në jug, krahasuar me verin, ekziston një përqindje më e lartë e të anketuarve që nuk pajtohen aspak se "Pavarësisht nga fitimi, nuk do të doja të bëja biznes me shqiptarët", dhe në veri ka më shumë të anketuar që ndajnë mendimin e kundërt. Nëse krahasojmë qëndrimet e të anketuarve sipas moshës, përqindja më e lartë e qëndrimeve negative është te të anketuarit mbi moshën 66 vjeçare, ndërsa në lidhje me nivelin e arsimit, ky qëndrim është më i përhapur në mesin e të anketuarve që kanë përfunduar shkollën e mesme.

Se kërkesat e konsumatorëve përcaktohen më së shpeshti nga raporti cilësi-çmim, në këtë studim u vërtetua të jetë i saktë, ku mbi 65% e komunitetit serb thanë se pajtohen me qëndrimin se nuk u intereson nëse pronari është shqiptar apo serb, por kush siguron shërbim/produkt më të lirë dhe më cilësor. Midis të anketuarve në komunat me shumicë serbe në jug, qëndrimi se nuk u intereson kush është pronar i kompanisë për sa kohë që ajo ofron një shërbim/pro-

dukt të përshtatshëm dhe të lirë ndahet nga 71.6% e të anketuarve, ndërsa mendim të kundërt kanë 17% e tyre. Në komunat veriore, kjo marrëdhënie është disi tjetër, kështu që për 59.4% të të anketuarve, çmimi i ulët dhe cilësia e mirë janë më të rëndësishme sesa përkatësia etnike e pronarit të kompanisë, por tek 31% ky përcaktues mund të luajë një rol në zgjedhjen e kompanisë që ofron një shërbim/produkt. Në këtë pyetje, një qëndrim pozitiv shoqërohet me një nivel të lartë arsimimi dhe status më të mirë material, ndërsa në lidhje me moshën e të anketuarve nuk ka ndarje të konsiderueshme, por qëndrimet pozitive dhe negative përfaqësohen në të gjitha moshat.

Nëse serbët nuk duan shqiptarë si punëdhënës apo shqiptarët nuk duan serbë në kompanitë e tyre janë pyetje që, ndër të tjera, ishin pjesë e hulumtimit të komunitetit serb në 10 komunat me shumicë serbe në Kosovë. Është interesante se rreth 20% e të anketuarve kanë një qëndrim neutral ndaj këtyre çështjeve. Pjesëtarët e komunitetit serb ende kanë një qëndrim më të përhapur se ata nuk dëshirojnë të punojnë në ndërmarrjet në pronësi të shqiptarëve (42.8%), ndërsa 35% nuk pajtohen me këtë mënyrë të të menduarit. Kur bëhet fjalë për mënyrën se si ata e shohin qasjen e punëdhënësve shqiptarë për të punësuar anëtarë të komunitetit serb, 58.2% besojnë se shqiptarët nuk e duan këtë, por ekziston një grup i caktuar i atyre që nuk pajtohen (21.1%). Se shqiptarët nuk duan serbë në ndërmarrjet e tyre është qëndrim po aq mbizotërues si në komunat veriore ashtu edhe në ato jugore, por nga ana tjetër ndarjet e tyre ndryshojnë në pyetjen nëse serbët duan apo nuk duan të punojnë për punëdhënësit shqiptarë. Në atë kuptim, në veri të Kosovës, shumica e të anketuarve pajtohen se serbët nuk dëshirojnë të punojnë në ndërmarrjet shqiptare, ndërsa në komunat jugore, shumica e të anketuarve nuk pajtohen me këtë qëndrim (48.1%).


3. Pengesat në të bërit biznes midis serbëve dhe shqiptarëve

Me vite ka pasur pengesa të shumta në të bërit biznes në mes të serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë, të cilat në shkallë të ndryshme ndikojnë në krijimin e marrëdhënieve afariste midis tyre. Sipas të

anketuarve nga komuniteti serb këto pengesa janë: mosbesimi midis komuniteteve, barrierat gjuhësore, mungesa e informacionit, mungesa e shoqatave të përbashkëta dhe të bërit biznes në dy sisteme juridike. Sipas mendimit të tyre, marrëdhënia e përgjithshme afariste midis serbëve dhe shqiptarëve është kryesisht e ndikuar nga mosbesimi i përgjithshëm ende i pranishëm midis këtyre dy komuniteteve, por edhe barriera gjuhësore, përkatësisht mosnjohja e gjuhës së komunitetit tjetër. Si e vlerësojnë të an-

ketuarit ndikimin e problemeve të tjera në biznesin e tyre është paraqitur në Grafikon 3. Në këtë pyetje, qëndrimet në veri dhe në jug janë të njëtrajtshme, me përjashtim të problemit të të bërit biznes në dy sisteme juridike (Kosovë dhe Serbi), ku 28.2% e të anketuarve nga komunat e jugut besojnë se ky problem nuk ndikon në mënyrë të konsiderueshme në bashkëpunimin afarist midis komunitetit serb dhe shqiptar, ndërsa në veri të Kosovës vetëm 10% e të anketuarve nuk e konsiderojnë këtë si problem.

Grafiku 3. Ndikimi i pengesave të ndryshme në të bërit biznes midis serbëve dhe shqiptarëve, në përqindje



Burimi: Rezultatet e hulumtimit mbi gjendjen e ekonomisë në komunitetet serbe në Kosovë


4. Ndikimi i taksave për importet nga Serbia në sjelljen e konsumatorit

Vendimi i Qeverisë së Kosovës nga nëntori 2019 për futjen e taksës prej 100% për importin e mallrave nga Serbia dhe BH shkaktoj pasoja të konsiderueshme në aspektin ekonomik dhe politik, por ndikimi i taksave nuk anashkaloi sjelljen e konsumatorëve nga zonat me shumicë serbe në Kosovë në blerjen e produkteve tradicionale. Bazuar në përgjigjet e marra, numri më i vogël i të anketuarve vendosën të zëvendësojnë produktet tradicionale me ato të prodhuara në Kosovë, dhe pastaj zgjedhja e dytë më e rrallë ishte zëvendësimi i produkteve të impor-

tuara nga vendet e tjera. Nga ana tjetër, zgjedhja më e zakonshme në mesin e konsumatorëve ishte udhëtimi i kohëpaskohshëm në Serbi për blerjen e produkteve të nevojshme, por ekziston një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve që menduan se taksat nuk ndikonin në mënyrë të konsiderueshme në furnizimin e tregut me produkte tradicionale serbe dhe se ato ishin në dispozicion në treg, mirëpo me çmime dukshëm më të larta.

Ndryshimet në sjelljen e të anketuarve në lidhje me blerjen e produkteve tradicionale serbe, si pasojë e vendosjes së taksave, ndryshojnë në komnat

Grafiku 4. Ndikimi i taksave për importet nga Serbia në sjelljen e konsumatorit



Burimi: Rezultatet e hulumtimit mbi gjendjen e ekonomisë në komunitetet serbe në Kosovë


veriore dhe jugore. Dallimi më dominues është ndikimi i taksave në zëvendësimin e produkteve tradicionale me ato të prodhuara në Kosovë ose të importuara nga një vend tjetër. Për shembull, në komunat në jug të lumit Ibër, 27% e të anketuarve vendosën të zëvendësojnë një produkt tradicional serb të paarrtshëm me një produkt të ngjashëm të prodhuar në Kosovë, ndërsa në veri përqindja ishte 7.3. Gjithashtu, sipas 38% të të anketuarve nga veriu, taksat nuk kanë ndikuar ndjeshëm në furnizimin e tregut me produkte tradicionale serbe, ndërsa në jug vetëm 20.3% ndajnë një mendim të tillë.

5. Ndikimi i pandemisë COVID-19 në tregtinë midis serbëve dhe shqiptarëve

Përveç problemeve tashmë të përmendura në të bërit biznes midis serbëve dhe shqiptarëve në

Kosovë, pandemia COVID-19 është edhe një tjetër gjendje që e ndërlikon edhe më tej tërë procesin. Kur bëhet fjalë për tregtinë, të anketuarit besojnë se pandemia kishte ndikimin më të madh në zvogëlimin e tregtisë midis dy komuniteteve, dhe ky mendim është më i përhapur në komunat në jug (41.9%) sesa në ato në veri (35.6%). Hulumtimi tregoi se 19.2% e të anketuarve besojnë se pandemia kontribuoi që shqiptarët të tregtonin më shumë në zonat serbe se zakonisht, dhe 11.4% besojnë se pasojë është që serbët të tregtojnë më shumë në mjediset shqiptare, krahasuar me periudhën para pandemisë. Në mesin e 13.6% të anketuarve ekziston një mendim se tregtia midis serbëve dhe shqiptarëve u përmirësua gjatë pandemisë, ndërsa një përqindje domethënëse prej 21.4% besojnë se tregtia midis dy komuniteteve nuk u kushtëzua nga ndikimi i pandemisë COVID-19.

Grafiku 5. Ndikimi i pandemisë COVID-19 në tregtinë midis serbëve dhe shqiptarëve




Burimi: Rezultatet e hulumtimit mbi gjendjen e ekonomisë në komunitetet serbe në Kosovë

6. Masat mbështetëse të Qeverisë së Kosovës për qytetarët që u përballen me pandeminë COVID-19

Pakoja Fiskale Emergjente e miratuar nga Qeveria e Kosovës, në përgjigje të situatës së re shëndetësore, përfshiu gjithashtu masa që ishin përcaktuar për të mbështetur qytetarët që përballen me pandeminë COVID-19. Masat përfshinin mbështetje financiare për ata që humbën vendet e tyre të punës gjatë pandemisë, si dhe për ata të

evidentuar si të papunë në Zyrën e Punësimit në Kosovë dhe grupe të tjera të cenuara të popullsisë. Në komunat me shumicë serbe, 18.5% e të anketuarve nuk ishin informuar fare se ekzistonin këto masa mbështetëse, dhe dy herë më shumë prej tyre ishin nga komunat në veri të Kosovës. 37% e të anketuarve vlerësuan se masat ishin të mira, ndërsa vetëm 4.1% i konsideruan masat si jashtëzakonisht të mira. Ndërsa, masat si aspak të mira u panë nga 16% e të anketuarve.

Grafiku 6. Vlerësimi i masave mbështetëse të Qeverisë së Kosovës për qytetarët që u përballën me pandeminë COVID-19



Burimi: Rezultatet e hulumtimit mbi gjendjen e ekonomisë në komunitetet serbe në Kosovë

4. Përmbyllja dhe rekomandimet

Specifikat e mjedisit kompleks juridiko-institucional dhe të sigurisë, pengesat tregtare për importet nga Serbia, qasja e pamjaftueshme në integrim ekonomik, si dhe pandemia e shkaktuar nga koronavirusi kanë lënë gjurmë në ekonominë e të gjitha komunave me shumicë serbe në Kosovë. Në këtë punim paraqitet struktura e sektorit privat dhe pengesat me të cilat përballen ndërmarrjet në dhjetë komuna me shumicë serbe në Kosovë, si dhe një pasqyrë e gjendjes aktuale të mjedisit afarist pas taksave dhe zbatimit të masave kundër pandemisë COVID-19.

Sa i përket strukturës së ndërmarrjeve, ngjashëm me pjesën tjetër të Kosovës, mjedisi afarist karakterizohet kryesisht nga ndërmarrjet që përqendrohen më shumë në veprimtarinë tregtare dhe më pak në prodhim. Bujqësia është veprimtaria e dytë më e përfaqësuar, e cila është më e zhvilluar në veri për shkak të kushteve të favorshme natyrore, kështu që dy të tretat e subjekteve ekonomike të regjistruara për të kryer këtë aktivitet gjenden në zonat serbe në veri të Kosovës. Në vitet e fundit, në një farë mase është zhvilluar edhe ndërtimtaria, kryesisht në bazë të investimeve të konsiderueshme në infrastrukturën komunale dhe ndërtimet publike (shkolla, spitale dhe infrastruktura të tjera publike).

Zhvillimi ekonomik i komuniteteve serbe në Kosovë është kryesisht i kushtëzuar nga prania e insti-

tucioneve të sektorit publik që veprojnë brenda sistemit serb ose kosovar. Në këtë kuptim, tenderët e shpallur nga institucionet publike, subvencionet e alokuara nga buxheti ose pagat në sektorin publik, mund të jenë një katalizatorë i rëndësishëm i tregtisë dhe zhvillimit të prodhimit. Nga ana tjetër, institucionet publike në këto zona punësojnë një numër të madh të punëtorëve dhe sigurojnë paga më të larta se në sektorin privat, kështu që afaristët përballen me problemin e gjetjes së punëtorëve, pavarësisht nga fakti se mund të ofrojnë një numër të vogël të vendeve të punës.

Marrëveshja e Brukselit solli disa risi që kanë një ndikim të favorshëm në biznes, duke filluar nga përfshirja e ndërmarrjeve në veri në sistemin juridik të Kosovës, rregullimit të kalimit përmes vendkalimeve të integruara administrative Jarinjë dhe Brnjak, deri te zhdoganimi i mallrave të destinuara për komunat veriore dhe bashkëpunimi midis odate ekonomike të Kosovës dhe Serbisë. Sidoqoftë, ende mbeten një numër sfidash me të cilat ballafaqohen bizneset në komunitetin serb në Kosovë.

Funksionimi brenda dy sistemeve juridike është një sfidë për sa i përket pagesës së dyfishtë të taksave dhe doganave, si dhe mbajtjes së dyfishtë të kontabilitetit. Afaristët në të njëjtën kohë janë të detyruar të ndjekin rregulloret në Serbi dhe Kosovë, që është veçanërisht një problem kur bëhet fjalë për rregulloret në Kosovë për shkak të mosnjohjes

së kompetencave të institucioneve dhe përkthimit të dobët të ligjeve dhe akteve nënligjore në gjuhën serbe.

Përkundër mungesës së të dhënave zyrtare, është e qartë se nuk ka investime të rëndësishme direkte të huaja ose të brendshme në ekonomi në zonat serbe në Kosovë. Qasja në tregjet financiare pengohet gjithashtu nga procedurat e shumta ligjore dhe administrative që afaristët nuk mund t'i përmbushin lehtësisht. Zgjidhja e të drejtave juridiko-pronësore dhe vërtetimi i suksesit të biznesit janë gjithashtu sfidë, veçanërisht kur bëhet fjalë për qasjen në kredi bankare dhe burime të tjera të financimit. Problemet në vërtetimin e suksesit dhe vazhdimësisë së biznesit paraqesin gjithashtu vështirësi kur aplikohet për tenderë publik të shpallur nga qeveritë lokale dhe institucionet e tjera që veprojnë brenda sistemit juridik të Kosovës. Duke qenë se afaristët nga komuniteti serb janë shumë rrallë anëtarë të shoqatave dhe odave ekonomike, nuk ka asnjë përgjigje të organizuar të afaristëve për të zgjidhur sfidat e përmendura. Këto probleme prekin veçanërisht afaristët në veri të Kosovës për shkak të integritimit jo të plotë të të gjitha institucioneve në sistemin juridik kosovar.

Futja e barrierave tregtare ndaj Serbisë nga Qeveria e Kosovës, fillimisht taksës 100% për importet e produkteve nga Serbia, dhe më vonë masave reciproke tregtare, ndikuan më tej në zhvillimin

e sektorit privat të komunitetit serb. Veçanërisht prodhuesit të cilët varen nga importet nga Serbia u preken nga kjo, kështu që kërkuan një rrugëdalje duke importuar nga vendet e tjera me çmime dukshëm më të larta ose duke zëvendësuar produkte dhe lëndë të para me ato me origjinë nga Kosova, të cilat nuk janë të një cilësie të kënaqshme. Kjo kishte një ndikim negativ në vëllimin e përgjithshëm të biznesit dhe plasimin e produkteve të tyre që kryesisht bëhet në mjediset serbe.

Kur bëhet fjalë për pandeminë COVID-19, lëvizja e kufizuar e qytetarëve dhe ndërprerja e aktiviteteve në sektorë të caktuar i shkaktoi humbje edhe bizneseve në mjediset serbe, pasi masat kufizuese shkaktuan një rënie të kërkesës agregate. Prandaj, Pakoja Fiskale Emergjente e Qeverisë së Kosovës, ku më shumë se gjysma e vlerës së kësaj pakoje ishte menduar për mbështetje financiare për sektorin privat, gjithashtu mbështeti ndërmarrjet nga këto zona, përkatësisht 781 prej tyre. Pasi që mbi 30,000 biznese janë mbështetur në të gjithë Kosovën përmes kësaj pakoje, mund të konkludohet se niveli i pjesëmarrjes së ndërmarrjeve serbe në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik të Kosovës është shumë i ulët.

Komunitetet serbe në Kosovë, veçanërisht në veri, janë kryesisht njësi ekonomike të izoluar me shumë pak marrëdhënie afariste me pjesën tjetër të Kosovës. Biznesi zhvillohet kryesisht brenda

komunës ose me komuna fqinje, ose me kompani serbe në pjesë të tjera të Kosovës. Sidoqoftë, ekziston një trend i dukshëm i rritjes së ndërgjegjësimit për integrimin në një treg më të madh, pasi 53% e të anketuarve besojnë se marrëdhëniet ekonomike midis ndërmarrjeve serbe dhe shqiptare në Kosovë duhet të forcohen. Megjithëse qasja në një treg më të gjerë do të ishte një faktor i rëndësishëm për rritjen ekonomike dhe integrimin ekonomik të afaristëve serbë në Kosovë, ka akoma një numër pengesash për krijimin e një niveli më të lartë të bashkëpunimit afarist midis bizneseve serbe dhe shqiptare. Ndër to më të spikatura janë mungesa e shoqatave të përbashkëta dhe odave ekonomike, qasja joadekuarte në informacion mbi mundësitë e bashkëpunimit, barrierat gjuhësore, por edhe mosbesimi i përgjithshëm që ekziston midis dy komuniteteve. Megjithëse bashkëpunimi afarist mund të jetë një nxitës shumë i fortë për ndërtimin e urave në mes të ndarjeve aktuale midis grupeve etnike në Kosovë, të anketuarit përveç pengesave të mësipërme, në kushtet e pandemisë COVID-19, konsiderojnë se vëllimi i tregtisë midis serbëve dhe shqiptarëve ishte zvogëluar.

Vendosja e marrëdhënieve më të mira afariste, si dhe integrimi i sektorit privat në ekonominë e Kosovës, nuk janë aktivitete që mund të shihen si të ndara. Ato varen nga aspektet sociale, të tilla si forcimi i besimit midis komuniteteve, dhe aspektet politike sikur funksionimi efikas i institucioneve qeveritare. Nëse këto parakushte plotësohen, bizneset do të mundë të nxiten që të krijojnë një bashkëpunimi afarist më të gjerë, i cili do të sigurojë përfitime ekonomike afatgjata për të dy komunitetet.

Bazuar në të gjitha sa më sipër, mund të nxirren rekomandimet e mëposhtme që mund të përmirësojnë ndjeshëm zhvillimin ekonomik në mjediset serbe në Kosovë.

- › Të punohet në fuqizimin e sundimit të ligjit dhe krijimin e një mjedisi të sigurt, politikisht të qëndrueshëm për investime, jo vetëm në komunitatet me shumicë serbe, por në të gjithë Kosovën;
- › Të punohet në krijimin e një sistemi mirë të zhvilluar të arsimit dhe aftësisë profesionale, në mënyrë që ndërmarrjet të sigurojnë punëtorë që plotësojnë nevojat e tyre;
- › Të sigurohen kushte më të favorshme në institucione financiare për marrjen e kredive për ndërmarrjet që krijojnë bashkëpunim me një entitet ekonomik nga një grup tjetër etnik;
- › Të zhvillohen programe që do të fuqizojnë anëtarësimin e ndërmarrjeve nga mjediset serbe në shoqata që do të kontribuonin në vendimmarrjen e tyre kolektive dhe do të avancojnë fuqinë e negociatave me institucionet publike;
- › Të punohet në fuqizimin e bashkëpunimit afarist ndërmjet ndërmarrjeve nga mjediset serbe, veçanërisht nga veriu, me pjesë të tjera të Kosovës, si dhe të promovohen shembuj të praktikës së mirë të bashkëpunimit afarist mbi baza ndëretnike;

Rreth nismës

"Demokracia, hapja dhe perspektiva e komunitetit serb në Kosovë - Open" është një nismë e re e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), e filluar në vitin 2020. Open zbatohet në bashkëpunim me nëntë organizata të shoqërisë civile që veprojnë në komunitetin serb në Kosovë.

Qëllimi i përgjithshëm i nismës së re është të zhvillojë një hapësirë të hapur dhe dinamike për diskutim brenda komunitetit serb, në mes të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera, si dhe institucioneve në Kosovë.

- Nisma do të adresojë në mënyrë specifike analizën dhe vlerësimin e ndikimit të organizatave civile dhe politike mbi demokracinë dhe hapjen e komunitetit serb në Kosovë.
- Do të analizohen dhe vlerësohen demokracia dhe hapja e institucioneve, politikat publike dhe proceset e rëndësishme ndaj komunitetit serb në Kosovë, si dhe shkalla e hapjes së komunitetit serb ndaj tyre.
- Këto analiza do të ndihmojnë për të kuptuar gjendjen aktuale dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë, përderisa në të njëjtën kohë do shërbejnë si bazë për përfaqësim argumentues ndaj qytetarëve, institucioneve të qeverisë lokale dhe qendrore si dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Organizatave me përvojë dhe të dëshmuara të shoqërisë civile, për të arritur qëllime të përgjithshme dhe specifike do të realizojnë tetë (8) analiza sektoriale.

Fushat që partnerët tanë do të analizojnë në vitin 2020 janë:

Mediat Sa ndikojnë mediat në gjuhën serbe në Kosovë në shkallën e hapjes, qasjes dhe pluralizmit të opinionëve dhe temave? Kjo fushë hulumtohet nga **Qendra Mediale** dhe **Bota bardh e zi**.

Shoqëria civile Si kontribuojnë organizatat e shoqërisë civile në hapjen dhe demokracinë e komunitetit serb dhe shoqërisë në Kosovë në përgjithësi? Me këtë temë merret **Iniciativa e re shoqërore** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietik**.

Partitë politike Demokracia dhe pluralizmi i partive politike serbe të Kosovës, hapja e tyre për të marrë pjesë në sistemin politik të Kosovës dhe për të kontribuar në avancimin dhe përmirësimin e politikave publike. Në këto çështje do të fokusohet **Iniciativa e re shoqërore** dhe **Qendra Mediale**.

Përgjegjësia e institucioneve Përmes monitorimit të kuptohet më mirë pozita e komunitetit serb në Kosovë dhe se sa të hapur janë institucionet ndaj problemeve të serbëve. Analiza realizohet nga **Bota bardh e zi** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietik**.

Siguria Sa ndikon ndjenja e sigurisë në hapjen e komunitetit serb ndaj institucioneve të sigurisë së Kosovës? Në këtë pyetje kërkon përgjigje **Qendra Humane Mitrovica**.

Ekonomia Sa janë të hapura entitetet ekonomike nga komunitetet me shumicë serbe për integrim në ekonominë e Kosovës? Këtë fushë e analizon **Instituti për Zhvillimin Ekonomik Territorial (InTER)**.

Të drejtat e pakicave Si të arrihet një shoqëri më e hapur duke vënë në pah boshllëqet në zbatim të së drejtave të pakicave? Kjo temë shqyrtohet nga **OJQ Aktiv** dhe **Qendra për të Drejtat e Komuniteteve të Pakicave**.

Procesi i dialogut dhe normalizimi i marrëdhënieve

Kosovë-Serbi - Deri në çfarë mase përfaqësohet dhe cilat janë qëndrimet e komunitetit serb të Kosovës lidhur me ndikimin dhe të ardhmen e procesit? Kjo analizë realizohet nga **OJQ Aktiv** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietik**.

Në fund të ciklit Open 2020 do të publikohet raporti i konsoliduar „**Karakteristikat e shoqërisë së hapur në komunitetin serb të Kosovës**“ duke i vendosë rezultatet dhe përfundimet e analizave bazë të anëtarëve të iniciativës Open në një kontekst më të gjërë socio-politik të Kosovës.

Iniciativa Open është e përkrahur nga KFOS

